

Nga
Geri Emiri



SI TË FAKTOJMË?!

Mini-udhëzues për
aktivistët lokal në
Shqipëri



SI TË FAKTOJMË?!

Mini-udhëzues për
aktivistët lokal në
Shqipëri

Nga

MSc. Geri Emiri

PËRMBAJTJA:

Fuqia e fakteve	6-8
Kërkimi i të dhënave	9-10
Databazat publike	11-14
Open Data	15
Databazat e Shoqërisë Civile	16-17
Advokimi përmes ligjit	18
Kërkesa për Informacion	19-21
Njoftimi dhe konsultimi publik	22-23
Këshilli Bashkiak	24-25
Peticioni	26-27
Ndihma juridike	28-31
Ruajtja e provave	32-35
Gazetaria qytetare	36



Përgatitur në kuadër të sesioneve me pjesëmarrësit e Programit "Shkëndija", që realizohet në kuadër të projektit "*Sparking Activism Initiatives Locally – SAIL III*", i zbatuar nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, me mbështetjen financiare të Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Shqipëri, si pjesë e programit "*Civil Society Capacity Building*".

E drejta e autorit: GERI EMIRI

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet ose transmetohet, në asnjë lloj forme apo mënyre, elektronikisht (CD, internet, etj.) ose mekanikisht, përfshirë fotokopjimin, regjistrimin apo ruajtjen e informacionit pa lejen paraprake me shkrim nga autori. Por nëse përdoret për qëllime jofitimprurëse, mjafton të citohet titulli i punimit dhe autori. Në këtë rast nuk nevojitet leje paraprake me shkrim nga autori.





FUQIA E FAKTEVE

Aktivizmi përfaqëson veprimin e një individi apo të një komuniteti, të cilët synojnë të sjellin ndryshime sociale, politike, ekonomike ose mjedisore, me qëllim arritjen e asaj që perceptohet si e mirë publike apo në interesin më të mirë të shumicës.

Përpara se të nisim advokimin nevojitet që ne të analizojmë çështjen që kemi identifikuar, për ta kthyer në një kauzë që përfaqëson interesat e një grupi më të gjerë shoqëror.

Në epokën e internetit qytetarët janë të mbingarkuar me informacione, një pjesë e të cilave publikohen jashtë filterave të verifikimit, duke shpërndarë informacione që mund të mos jenë të vërtetuara.

Rëndësia e argumentimit

Krijimi i një komuniteti që bashkohet me ju për të adresuar një problem apo për të ngritur një kauzë kërkon një punë parapërgatitore që fokusohet tek procesi i bindjes.

Shpesh herë qytetarët përballen me problemin në përditshmërinë e tyre, e njohin atë, e shmangin, nuk tentojnë t'i japin zgjidhje dhe mund të mos kenë njohuri të plota mbi të.

Shpesh herë në artikullimin e këtyre problemeve në fokus vendoset informacioni me karakter konstatues, akuza, duke drejtuar gishtin ndaj autoriteteve përgjegjëse dhe argumentimi përmes fakteve del në plan të dytë ose nuk përfshihet fare.

Diferenca në ngritjen e një kauze dhe në marrjen e vëmendjes së opinionit publik qëndron në përfshirjen e të dhënave, shifrave, dokumenteve dhe informacioneve që ekspozojnë autoritetet publike, palët e përfshira, duke treguar qartë përgjegjësitë dhe nevojat.

Qasja përmes të dhënave ju ndihmon të kuptoni më në thellësi problemin dhe mënyrat se si ai mund të adresohet, duke identifikuar jo vetëm përgjegjësit, por edhe duke kuptuar zgjidhjet konkrete.

Përfaqësuesit publik dhe media janë të prirur të lexojnë dhe të dëgjojnë shifra, dokumente, statistika, të dhëna, fotografi dhe video me karakter dokumentues, të cilat faktojnë më tej problemin e konstatuar.

Gjetjet tuaja ju shërbejnë që ta orientoni kauzën drejt zgjidhjeve institucionale, faktet janë "avokatët" tuaj në përballjen me aktorë të ndryshëm, përfshirë institucionet shtetërore, organet gjyqësore. Gjithashtu kauza e rrëfyer përmes fakteve bëhet edhe më tërheqëse për median dhe ju rrit besueshmërinë në sytë e opinionit publik.



#Shkëndija #NAD

7 X



Cilat janë përfitimet e faktimit?

01

E vërtetoni ose e hidhni poshtë hipotezën tuaj;

02

Bëheni të besueshëm;

03

Mbani përgjegjës subjektet publike ose private;

04

Tërhiqni vëmendjen e medias;

05

Mbroni veten nëse ju akuzojnë;

06

Mund t'i drejtoheni institucioneve dhe gjykatës;

07

Orientoheni drejt zgjidhjeve.



Nga t'ia nis?!



Fillimi i kërkimit mund të jetë në internet, pasi media mund të ketë raportuar më herët për kauzën tuaj, më tej kërkimi i raporteve të Organizatave të Shoqërisë Civile, në faqet e institucioneve, leximi i të dhënave në raportet apo në databazat e modelit “open data”.

Më pas nevojitet identifikimi i burimeve, personave që mund të kenë dijeni për temën dhe kontaktimi i tyre në një fazë të dytë, e cila ndihmon në pasurimin me informacion mbi çështjen.


Pushteti vendor është përgjegjës për shërbimet e ofruara ndaj komunitetit të një qarku të caktuar. Vendosija e lupës tek fushat që ai mbulon, mund të gjenerojë të dhëna që informojnë më tej komunitetin tuaj dhe e forcojnë advokimin.

Burimet “offline” mund të ofrojnë të dhëna që nuk janë të digjitalizuara. Kërkimi në arkivë apo në bibliotekë, për libra, botime shkencore dhe raporte, mund t’ju ndihmojë me të dhëna që plotësojnë kauzën.

Mbi të gjitha që kauza të tërheqi vëmendjen e komunitetit dhe masës ajo duhet të shkojë përtej interesit personal dhe të ketë pjesë të asaj atë që përkufizohet si “interes publik”, duke bartur nevojat apo kërkesat e një grupi shoqëror bazuar në argumente.

DATABAZA

Baza e të dhënave përbën grumbullimin e të dhënave kompjuterike që paraqiten në mënyrë të organizuar. Ajo ofrohet në internet përmes programeve që shërbejnë për të mbajtur, ruajtur dhe përdorur lehtësisht të dhënat. Ato mund të menaxhohen nga autoritetet publike ose subjektet private dhe qëllimi i tyre lidhet me misionin e këtyre organizatave.



Open data

Synimi i "Open Data" është të ofrojë të dhëna të hapura, të vizitueshme, të shfrytëzueshme, të redaktueshme dhe të cilat mund të ndahen nga kushdo. Ato licencohen sipas një "licence të hapur" dhe ndihmojnë qeveritë, bizneset dhe shoqërinë civile, të cilat mund të jenë edhe krijuesit e databazave të këtij profili.

Databazat publike

🔍 WWW.....gov.al ✕

okb.gov.al

Qendra Kombëtare e Biznesit

Faqja www.qkb.gov.al përmban një databazë të të gjitha bizneseve të regjistruara në Shqipëri, nga bizneset e vogla tek korporatat e mëdha, përfshirë informacion mbi aksionarët, drejtorët e kompanive, anëtarët e bordeve dhe disa të dhëna financiare. Në kategorinë “Kërko për subjekt”, ju mund të gjeni të dhëna rreth bizneseve. Kërkimi në të mund të realizohet duke vendosur emrin e subjektit apo të aksionarëve, por ky kërkim nuk është gjithmonë efikas. Për të shmangur vështirësitë, gjeni numrin e NIPT-it dhe vendoseni në kutinë përkatëse të kërkimit.

App.gov.al

Agjencia e Prokurimit Publik

Faqja www.app.gov.al përmban një databazë të prokurimeve publike aktuale si edhe njoftimet e fituesve të tenderave të ndryshëm, të zhvilluara gjatë muajve të fundit. Të dhënat historike fshihen në mënyrë të vazhdueshme. Çdo ditë të hënë, APP publikon Buletinin e Njoftimeve Publike, në të cilin gjendet informacion në lidhje me njoftimet e procedurave të prokurimit, koncesioneve/partneritetit publik privat dhe ankandeve publike, si dhe çdo informacion tjetër i nevojshëm për publikim.

🔍 #Shkëndija #NAD

11 ✕

Databazat publike

Konsultimipublik.gov.al

Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike

Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin numër 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Autoritetet publike janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik. Faqja www.konsultimipublik.gov.al mirëmbahet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe në të publikohen projekt aktet për njoftimin dhe konsultimin publik. Ajo shërben si pikë qendrore konsultimi dhe nëpërmjet këtij regjistri sigurohet qasje dhe ofrohet mundësia e komunikimit të të gjitha palëve të interesuara me autoritetin publik. Konsultimet në faqe ndahen në dy kategori: Për qytetarët dhe për ekspertët. Gjithashtu aty gjenden raportime dhe dokumente të tjera për të gjitha institucionet sipas fushave përkatëse.

Konsultimivendor.al

Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike në Nivel Vendor

Në faqen www.konsultimivendor.al publikohen projekt aktet e njësisë të vetëqeverisjes vendore, ndarë në dy kategori: Për qytetarët dhe për ekspertët. Gjithashtu aty publikohen raportet e konsultimeve publike të njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe fotografi e raporte nga këto takime.



#Shkëndija #NAD

12 X

Databazat publike

Instat.gov.al

Instituti i Statistikave

Faqja www.instat.gov.al publikon statistikat zyrtare të shtetit shqiptar në disa fusha: Anketa e buxhetit të familjes; E matjes së nivelit të jetesës; E përdorimit të kohës; Anketa e strukturës së të ardhurave nga puna; Arsimi; Barazia gjinore; Blegtoria; Bujqësia; Çmimet; Energjia; Informacioni dhe teknologjitë e komunikimit; Informacioni ekonomik për ndërmarrjet; Kosto e punës; Krimet dhe drejtësia penale; Kultura; Lindjet, vdekjet dhe martesat; Llogaritë ekonomike të mjedisit; Llogaritë kombëtare (PBB); Migracioni dhe integrimi i migrantëve; Mjedisi; Ndërtimi; Pagat; Peshkimi; Popullsia; Post-telekomunikacioni; Projektionet; Pyjet; Regjistrat e biznesit; Shëndetësia; Sigurimet shoqërore dhe mbrojtja sociale; Statistikat afatshkurtra; Të mësuarit gjatë gjithë jetës; Transporti; Tregtia e jashtme; Tregtia me pakicë; Tregu i punës; Turizmi dhe anketa të tjera.

Gjykata.gov.al

Gjykatat e Republikës së Shqipërisë

Faqja www.gjykata.gov.al ofron akses në vendimet e gjykatave të faktit, të apelit dhe lidhje me faqet përkatëse të internetit të këtyre gjykatave. Gjykatat e rrethit, gjykatat e apelit dhe gjykatat administrative zhvillojnë çdo ditë seanca që mund të paraqesin interes, në këto faqe gjendet "kalendari i seancave" dhe vendimet gjyqësore të karakterit "penal" dhe "civil".

Bashkitë



opendata.tirana.al



Bashkia e Tiranës ofron të dhëna përmes faqes së dedikuar opendata.tirana.al - ajo është pjesë e nismës për të dhëna të hapura dhe aty ngarkohen informacione me karakter statistikor dhe cilësor, për shërbimet që ofron bashkia. Platforma dhe hapësira të tilla në faqet e bashkive të vendit ofrojnë të dhëna të rëndësishme për aktivistët që duan të mësojnë më shumë për çështjet që prekin komunitetin e tyre.



Bashkia Durrës



Faqet e njësive të vetëqeverisjes vendore janë të pasura me informacione që nisin që nga ofrimi i shërbimeve, deri tek buxheti afatmesëm. Këto faqe janë një burim i rëndësishëm i gjetjes së të dhënave që lidhen me bashkitë, në të cilat publikohen të dhëna për veprimtarinë e përditshme dhe atë me karakter vendimmarrës. Disa prej seksioneve më të rëndësishme të cilat shërbejnë për të ofruar të dhëna janë "Programi i Transparencës", në të cilin përshkruhet struktura e bashkisë, informacionet për organizimin e saj, këshillin bashkiak, të dhëna që bëhen publike pa kërkesë dhe kontaktet e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, përmes të cilit mund të depozitohen Kërkesa për Informacion; Seksioni i "Këshillit Bashkiak" përmban informacione të rëndësishme për funksionimin e tij, komisionet, kalendari i mbledhjeve dhe vendimet e marra; "Konsultimi Publik" është një seksion tjetër i rëndësishëm për të ndjekur projekt aktet që shqyrtohen dhe paraqiten për konsultim përpara miratimit përfundimtar.



#Shkëndija #NAD

14 X

Open Data

🔍 [www.open.....al](#) ✕

Vendime.al

Arkiva Kombëtare e Akteve Legjislative të Pushtetit Vendor

www.vendime.al është platforma kombëtare ku publikohen vendimet e këshillave bashkiakë të Republikës së Shqipërisë. Platforma përfaqëson Arkivën Kombëtare të Akteve Legjislative të Pushtetit Vendor.

Openprocurement.al

Prokurimet e Njësive të Qeverisjes Vendore

www.openprocurement.al është një databazë që i dedikohet prokurimeve publike dhe formave të tjera që lidhen me përdorimin e parave publike. Ajo është krijuar nga "Albanian Institute of Science" ("Instituti Shqiptar i Shkencave"). Brenda platformës gjendet kategoria "Prokurime Publike Njësi të Qeverisjes Vendore", e cila pasqyron të gjitha tenderat që zhvillon pushteti vendor.

🔍 #Shkëndija #NAD

15 ✕

🔍 WWW.....al ✕

Financatvendore.al

Financat Vendore

www.inancatvendore.al është një platformë elektronike e hapur për të dhënat financiare në nivel vendor. Qëllimi i saj është mundësimi i të dhënave mbi financat vendore në mënyrë sistematike dhe të kuptueshme për publikun. Kjo platformë përmbledh për herë të parë të dhënat mbi të ardhurat dhe shpenzimet faktike për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore në vend prej vitit 2010. Ajo u ndërtua nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, OSFA dhe aktualisht mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Vullnetarizmi.al

Platforma Digjitale e Vullnetarizmit në Shqipëri

www.vullnetarizmi.al është një platformë kombëtare digjitale ndërvepruese për vullnetarizmin në Shqipëri, si një mjet promovues, informativ, lehtësues dhe i organizuar për rekrutimin e vullnetarëve, por edhe një risi në mbledhjen dhe ofrimin e të dhënave cilësore dhe sasiore në këtë fushë. Ajo ofron rritje të kapaciteteve, burime dhe mjete për të gjithë aktorët e interesuar në sektorin e vullnetarizmit.

🔍 #Shkëndija #NAD

16 ✕

Databazat e Shoqërisë Civile

Juristionline.al

Juristi Online

www.juristionline.al ofron ndihmë dhe shërbime ligjore nëpërmjet "Centre for Legal Empowerment" ("Qendra për Fuqizimin Ligjor"), me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Qytetarët mund të këshillohen dhe të informohen lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas legjislacionit në fuqi, dhënien e ndihmës në hartimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje organet publike ose në kuadër të marrëdhënieve me personat juridikë dhe fizikë privatë dhe raste të tjera.

Portavendore.al

Porta Vendore

www.portavendore.al synon krijimin e një mjedisi mbështetës për demokracinë vendore dhe përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrjen lokale, duke përmirësuar informimin e qytetarëve mbi funksionet dhe përgjegjësitë e bashkisë, duke forcuar gazetarinë vendore dhe duke advokuar për më shumë transparencë dhe llogaridhënie të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Km.levizalbania.al

Platforma e Njohurive për Angazhimin Qytetar


www.km.levizalbania.al është një platformë që përmbledh projektet e "Lëviz Albania", një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC që zbatohet nga konsorciumi i tre organizatave shqiptare, "Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë", "Partneret Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim" dhe "Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit". Aty mund të gjeni të dhëna me rëndësi për komunitetin apo qytetin tuaj, duke kërkuar në platformë përmes kategorive të përcaktuara.



#Shkëndija #NAD

17 X

Advokimi përmes ligjit



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

☆☆☆ #shkëndija2023

Mjetet ligjore janë forma e drejtpërdrejtë e ushtrimit të demokracisë, duke ndihmuar edhe në avancimin e kauzës suaj. Në Shqipëri është miratuar Ligji numër 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", që siguron për publikun akses më të madh në dokumentet zyrtare, si edhe penaltete konkrete për zyrtarët publik që refuzojnë të japin informacionin e kërkuar.

Ligji numër 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", i detyron organet publike të njoftojnë dhe të realizojnë konsultime publike të projektligjeve, projekt dokumenteve strategjike kombëtare dhe

vendore, politikave me interes të lartë publik, publikimin e planeve vjetore lidhur me procesin e vendimmarrjes dhe dhënien e informacionit në të gjitha fazat.

Pjesëmarrja në mbledhjet e këshillit bashkiak është e garantuar me ligj dhe në çdo rast autoriteteve publike në nivel vendor dhe qendror mund t'i drejtohen peticione që kërkojnë ndërhyrje që bazohen në ligj. Gjithashtu "avokatët e shoqërisë civile" janë një burim i rëndësishëm i ndjekjes së kauzave përmes formave ligjore, duke marrë mbështetje dhe orientime për adresimin tek autoritetet publike.

🔍 #Shkëndija #NAD

18 X

Nga buron?!

Përmes Ligjit nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", mund t'i dërgohen "Kërkesa për Informacion" autoriteteve publike dhe të merren të dhëna apo dokumente publike. Çdo qytetar ka të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë arsyet e kërimit të informacionit.

DREJTË

AKSES ONLINE

**INFORMIMI
PRIVATËSI
TË DHËNA**

**SI
PROG**

»»»» Kërkesa për Informacion

Po nëse nuk merrni përgjigje?!

Në rast se ju vlerësoni se ju janë shkelur të drejtat për të marrë informacion mund të ankoheni pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda 30 ditëve punë, nga dita kur ju nuk keni marrë njoftim për refuzimin e kërkesës ose kur nuk keni marrë përgjigje (pra ka kaluar afati ligjor për dhënien e informacionit të kërkuar, 10 ditë pune).



#Shkëndija #NAD

19 X



PYET SHTETIN

Platforma www.pyetshtetin.al është një iniciativë e përbashkët e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, i cili ju vjen në ndihmë për të dërguar Kërkesa për Informacion dhe të gjeni kontaktet e nevojshme.

Në këtë seksion gjeni kontaktet që përfshijnë adresën, faqen zyrtare, kontaktin e koordinatorit për të drejtën e informimit, emailin, numrin e celularit dhe programin e transparencës për të gjitha institucionet në nivel qendror.

Link: www.pyetshtetin.al/pushteti-qendror/

KËRKESA PËR INFORMACION

Në rast se ju çmoni se ju janë shkelur të drejtat për të marrë informacion keni të drejtë të ankoheni në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Formatin e formularit e gjeni të gatshëm në platformë në seksionin "Ankesa".

ANKESA

PUSHTETI QENDROR

Në këtë seksion gjeni kontaktet që përfshijnë adresën, faqen zyrtare, kontaktin e koordinatorit për të drejtën e informimit, emailin, numrin e celularit dhe programin e transparencës për të gjitha institucionet në nivel qendror.

Link: www.pyetshtetin.al/pushteti-qendror/

PUSHTETI VENDOR

Në këtë seksion gjeni kontaktet që përfshijnë adresën, faqen zyrtare, kontaktin e koordinatorit për të drejtën e informimit, emailin, numrin e celularit dhe programin e transparencës për të gjitha institucionet në nivel qendror.

Link: www.pyetshtetin.al/pushteti-qendror/



#Shkëndija #NAD

20 X

DREJTORITË E PËRGJITHSHME

Në këtë seksion gjeni kontaktet që përfshijnë adresën, faqen zyrtare, kontaktin e koordinаторit për të drejtën e informimit, emailin, numrin e celularit dhe programin e transparencës për të gjitha drejtoritë e përgjithshme të qeverisë shqiptare.

Link: www.pyetshtetin.al/drejtore-e-pergjithshme/

INSTITUCIONE TË PAVARURA

Në këtë seksion gjeni kontaktet që përfshijnë adresën, faqen zyrtare, kontaktin e koordinаторit për të drejtën e informimit, emailin, numrin e celularit dhe programin e transparencës për të gjitha institucionet e pavarura të shtetit shqiptar.

Link: www.pyetshtetin.al/institucionet-e-pavarura/

SHOQËRITË TREGTARE

Në këtë seksion gjeni kontaktet që përfshijnë adresën, faqen zyrtare, kontaktin e koordinаторit për të drejtën e informimit, emailin, numrin e celularit dhe programin e transparencës për të gjitha shoqëritë tregtare ku shteti shqiptar ka shumicën e aksioneve.

Link: www.pyetshtetin.al/shoqeri-tregtare/

SISTEMI I DREJTËSISË

Në këtë seksion gjeni kontaktet që përfshijnë adresën, faqen zyrtare, kontaktin e koordinаторit për të drejtën e informimit, emailin, numrin e celularit dhe programin e transparencës për të gjitha institucionet e drejtësisë.

Link: www.pyetshtetin.al/sistemi-i-drejtewise/

AUTORITETE TË TJERA

Në këtë seksion gjeni kontaktet që përfshijnë adresën, faqen zyrtare, kontaktin e koordinаторit për të drejtën e informimit, emailin, numrin e celularit dhe programin e transparencës për institucionet, agjencitë, urdhërat, qendrat, universitetet dhe autoritetet e tjera publike që funksionojnë në Shqipëri.

Link: www.pyetshtetin.al/institucione-te-tjera/

DHE KONSULTIMI PUBLIK



Regjistri Elektronik për Njoftimet
dhe Konsultimet Publike

Ligji nr. 146/2014

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi më 30 tetor 2014 Ligjin nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Ai ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve që krijohen në një proces të konsultimit publik, transparent, gjithëpërfshirës, të realizuar në kohë dhe efektiv ndërmjet organeve publike qendrore, vendore dhe palëve të interesuara, në procesin e vendimmarrjes së projekt akteve si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si edhe të politikave me interes të lartë publik.

Ankimi

Ligji ka parashikuar ankimin pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në rast se palët e interesuara vlerësojnë se organi publik ka cenuar të drejtën e tyre për njoftim dhe konsultim publik dhe kur nuk janë respektuar afatet e parashikuara në ligj.



Marrja e masave

Komisioneri kur arrin në përfundimin se ka shkelje të dispozitave të ligjit, i propozon organit publik përgjegjës marrjen e masave administrative ndaj personit apo personave përgjegjës, sipas legjislacionit për shërbimin civil në fuqi.

NË NIVEL VENDOR



Regjistri Elektronik për Njoftimet
dhe Konsultimet Publike
në nivel vendor

Faqet e bashkive

Faqet e njësive të vetëqeverisjes vendore ofrojnë informacione për konsultimet publike. Shumica prej tyre e kanë të përcaktuar në një kategori të veçantë "Konsultimin Publik" dhe mund të gjendet në rubrikat kryesore ose në atë të "Këshillit Bashkiak". Aty vendosen projekt aktet që pritet të konsultohen me publikun, si edhe të dhëna për takimet fizike që lidhen me to.

Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike në Nivel Vendor

✓
✓
✓
✓
Faqet e njësive të vetëqeverisjes vendore ofrojnë informacione për konsultimet publike. Shumica prej tyre e kanë të përcaktuar në një kategori të veçantë "Konsultimin Publik" dhe mund të gjendet në rubrikat kryesore ose në atë të "Këshillit Bashkiak". Aty vendosen projekt aktet që pritet të konsultohen me publikun, si edhe të dhëna për takimet fizike që lidhen me to.

Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike

Autoritetet publike janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik. Në faqen www.konsultimipublik.gov.al publikohen projekt aktet për njoftimin dhe konsultimin publik. Ajo shërben si pikë qendrore konsultimi dhe nëpërmjet këtij regjistri sigurohet qasje dhe ofrohet mundësia e komunikimit të të gjitha palëve të interesuara me autoritetin publik.

A mund ta ndiqni mbledhjen e këshillit bashkiak?!

Ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", në nenin 17 përcakton se, "Mbledhjet e këshillit janë të hapura për publikun. Çdo qytetar lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit".




»»»» Mbledhjet e Këshillit Bashkiak



E drejta e kërkesës, ankesës dhe vërejtjes

Sipas Nenit 19 të Ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore": "Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë t'u drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore".





E drejta e iniciativës qytetare

Sipas Nenit 20/1 të Ligjit nr. 139/2015 gjithashtu: "Çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij ose jo më pak se një për qind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendimmarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore".

»»»» Mbledhjet e Këshillit Bashkiak

Dëgjesat publike dhe buxheti

Bashkitë prezantojnë planin buxhetor në njësitë administrative sipas një kalendari takimesh, gjatë të cilave mund të referohen kërkesat e komunitetit. Gjithashtu projektet e rëndësishme që ndikojnë në transformimin e qytetit mund të kalojnë përmes dëgjesave publike.



Peticioni

Përfaqëson një kërkesë apo ankesë që i drejtohet Këshillit Bashkiak ose komisionit të përhershëm të Këshillit Bashkiak, për ta nxitur atë të ndërmarrë apo të mos ndërmarrë një veprim apo vendim me interes për bashkësinë apo territorin e bashkisë. Peticioni bazohet në Nenin 19 të ligjit nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore".

Çdo qytetar, grup që përfaqëson komunitetin apo Organizatë Jo-Qeveritare ka të drejtë t'i drejtojë kërkesa Këshillit Bashkiak për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e bashkisë. Këshilli Bashkiak ka detyrimin ligjor të marrë në shqyrtim kërkesat dhe të kthejë përgjigje brenda afateve të përcaktuara sipas rregullores së tij.

Peticionet që njihen si "të zakonshme", janë ato që kanë më pak se 20 apo 50 nënshkrime të vlefshme dhe i përcillen drejtorisë përkatëse nga sekretari i këshillit. Ndërsa petitionet që kanë të paktën 20 apo 50 nënshkrime të vlefshme nëpërmjet sekretarit të këshillit i përcillen fillimisht drejtorisë përkatëse të bashkisë, e cila duhet ta shqyrtojë dhe t'i përgjigjet parashtruesit kryesor të petitionit brenda 20 ditëve nga data e dorëzimit të petitionit në bashki.



"Rrugëtimi i petitionit"

Peticionet që mbledhin mbi 100 apo 500 nënshkrime të vlefshme, pasi pranohen nga "Komisioni i Peticioneve" në bashki, dërgohen për shqyrtim nga kryetari i këshillit tek komisioni i përhershëm përkatës, i cili ka objekt të veprimtarisë së tij çështjen që paraqet petitioni.

Ndërsa Peticionet e pranuar nga Komisioni i Peticioneve dhe që kanë mbi 1000 nënshkrime të vlefshme i paraqiten për njoftim këshillit në mbledhjen më të afërt.

Kërkesa e petitionit që pranohet njoftohet dhe publikohet në faqen e internetit të bashkisë dhe në një vend të njoftimeve publike të saj.

KUJDES!

Këshillat bashkiak në bashkitë e vendit kanë miratuar rregulloren e tyre për paraqitjen, shqyrtimin e peticioneve dhe të iniciativave qytetare. Kjo rregullore dikton formatin e peticionit në çdo formë, fizike apo elektronike, mënyrën e mbledhjes së të dhënave dhe depozitimin e tyre.

Rregullat e zhvillimit të peticionit duhet të lexohen paraprakisht sipas rregullores së bashkisë përkatëse dhe po sipas tij duhet zhvilluar formulari i peticionit.

Çfarë vendimi mund të marrë këshilli bashkiak për një peticion?

- Mund ta miratojë kërkesën e peticionit me ose pa ndryshime;
- E refuzon kërkesën e peticionit;
- Zhvillon një dëgjese publike në lidhje me çështjen e peticionit;
- Ndërmerr një hulumtim rreth çështjes së peticionit.



Çdo peticion iniciohet nga minimalisht 3 parashtres, të cilët janë votues në bashki dhe mbi 18 vjeç ose nga një Organizatë e Shoqërisë Civile, që nënshkruhet nga mbështetësit.

Një peticion duhet të përmbajë së paku citimin: "Drejtuar Këshillit Bashkiak"; Bazën ligjore: "Neni 19 i Ligjit 139/2015"; Titullin e peticionit; Peticioni fillon me: "Ne të nënshkruarit, me këtë peticion, i kërkojmë Këshillit Bashkiak..."; Arsyet e paraqitjes së peticionit; Të dhënat e parashtresve të peticionit: Emrat, letërnjoftimet, adresat dhe kontaktet; Përshkrimi: "Të dhënat personale do të përdoren vetëm për qëllimet e peticionit"; Afatin: Data dhe ora e përfundimit të nënshkrimeve të peticionit dhe vijimi i nënshkrimeve vijon sipas versionit më poshtë:

Nr.	Emri	Mbiemri	ID	Njësia Administrative	Firma
1					

Ndihma juridike

Përgjatë rrugëtimit tuaj mund të keni pikëpyetje të ndryshme që lidhen me organet e qeverisjes vendore apo qendrore. Është e rëndësishme të kuptoni ligjin dhe mundësitë që ai ofron për ju, me qëllim advokimin e suksesshëm.

Aktualisht Ministria e Drejtësisë dhe Organizatat e Shoqërisë Civile ofrojnë ndihmë juridike falas. Ju mund t'i drejtoheni atyre për nevojat që keni në kuptimin dhe përdorimin e mjeteve ligjore.

Juristi online

Në platformën www.juristionline.al qytetarët mund të këshillohen dhe të informohen lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas legjislacionit në fuqi, dhënien e ndihmës në hartimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje organet publike ose në kuadër të marrëdhënieve me personat juridikë dhe fizikë privatë dhe raste të tjera.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Komiteti Shqiptar i Helsinkit synon të kontribuojë në respektimin e të drejtave të njeriut, forcimin e shtetit të së drejtës dhe në zhvillimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme. "Klinika Ligjore" e ngritur brenda tij ofron shërbime juridike falas për qytetarët të cilët nuk kanë mundësi financiare të kenë akses në organet e drejtësisë dhe pretendojnë shkelje të të drejtave të njeriut, si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të autoriteteve publike.

Komiteti përfaqëson në gjykatë raste të "litigimit strategjik" dhe "class action", ku përmes rasteve individuale synohet zgjidhja e problematikave për një grup të gjerë njerëzish që ndodhen në të njëjtën situatë ose synohet përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional në interes të të drejtave dhe lirive të shtetasve.

Gjithashtu Komiteti mund të vendosi në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjeve, si edhe Gjykatën e Strasburgut, për shkelje të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Ndihmë juridike parësore

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lushnje; Adresa: Lagjja "Kongresi i Lushnjes", Rr. "Bajram Haxhiu", pranë Bashkisë Lushnjë.	Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Dibër; Adresa: Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Durrës; Adresa: Lagjja Nr.2, Rruga "Aleksandër Goga", pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.	Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Fier; Adresa Rruga "Rr. Ramiz Aranitasi, në ambientet e ADISA Fier.
Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, Tiranë; Adresa: Bulevardi "Zogu I", pranë Ministrisë së Drejtësisë.	Organizatat Jo-fitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë:
Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, Pogradec; Adresa: Bulevardi Rreshit Çollaku, Lagjja nr. 2, pranë Bibliotekës Mitrush Kuteli.	Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Qytetare dhe Fshatare Berat; Lagjja "30 vjetori", Berat.
Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Gjiroksatër; Adresa: Bulevardi "18 Shtatori", në ambientet e ADISA Gjirokastër.	"Albanian Legal and Territorial Research Institute"; Rr. "Asim Zeneli", nr. 15, Tiranë.
Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lezhë; Adresa: Blv. "Gjergj Fishta", pranë Bashkisë Lezhë.	Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA); Rr. "Perlat Rexhepi", Pall. "Ana", h. Nr. 7, ap. Nr. 18, Tiranë.
Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër; Adresa Rruga "Don BOSKO", pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.	Forumi i Gruas Elbasan; Lagjja 5 Maji, Rr. "M. Shqiptari", p. 450/1, Elbasan.
Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Vlorë; Adresa Rruga "Zigur Lelo", pranë Bashkisë Vlorë.	Qendra Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza; Rr. "Muhamet Gjollesha", nd. Nr. 122, h. 4, ap. 8, Tiranë.

Ndihmë juridike parësore

Intelektualët e Rinj Shpresë; Lagjja "Qemal Stafa", Rr. "Daut Boriçi" nr. 874, Shkodër.	Klinika e Ligjit pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë; Rr. Milito Tutulani Tiranë.
Qendra Konsumatori Shqiptar; Lagjja nr. 11, Rr. "Kumini", p. nr. 1319, Durrës.	Klinika e Ligjit pranë Kolegjit Universitar "Bedër". Rr. "Jordan Misja", Tiranë.
Qendra për Nisma Ligjore Qytetare; Rr. "Vaso Pasha", p. 12, shk. 1, ap. 1, Tiranë.	Klinika e Ligjit pranë Kolegjit Universitar "Wisdom"; Rr. Medar Shtylla, Komuna e Parisit, Tiranë.
Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara; Blv. "Gjergj Fishta", nd. 26, ap. 24, Tiranë.	Klinika e Ligjit pranë Kolegjit Universitar "Aleksandër Moisiu" Durrës; Rr. Currila, Durrës.
Qendra të Ndryshëm dhe të Barabartë; Rr. "Fortuzi", nd. 24, shk. 4, ap.4, Tiranë.	Klinika e Ligjit pranë Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; Rr. Kosova, Skelë, Vlorë.
Qendra Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS); Blv. "Bajram Curri", Pallatet "Agimi", shk. 18, ap. 322.	Klinika e Ligjit pranë Universitetit European të Tiranës; Bulevardi Gjergj Fishta Nd. 70 H.1, Tiranë.
Shoqata Shërbimet Shqiptare për Refugjatët dhe Migrantët; Sheshi "Karl Topia", nd. "Trema engineering" 2, k. 3, ap. 6, Tiranë.	Klinika e Ligjit pranë Universitetit "Qirjazi; Rruga Taulantët, Kodër-Kamëz, Tiranë.
- Klinikat e Ligjit pranë universiteteve me të cilat janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi:	Klinika e Ligjit pranë Universitetit "Mesdhetar të Shqipërisë"; Bulevardi Gjergj Fishta, Tiranë.
Klinika e Ligjit Shkodër; Adresa: Rruga "Kolë Idromeno", Shkodër.	Klinika e Ligjit pranë Universitetit "Marin Barleti", Rr. "Frang Bardhi", Tiranë.



Ndihmë juridike dytësore

Në bazë të Ligjit Nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", qytetarët mund të përfitojnë:

- Ndihmë ligjore falas për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën;
- Ofrim i këshillimit ligjor falas për të vënë në lëvizje gjykatën;
- Përfaqësim dhe mbrojtje falas para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale;
- Përjashtimin nga pagesa e tarifave gjyqësore;
- Përjashtimin nga shpenzimet gjyqësore.

Çdo qytetar për të verifikuar nëse përmbush kriteret e përcaktuara në ligj për të përfituar nga shërbimet e mësipërme mund të kontaktojë në adresat elektronike:

Ndihma.Juridike@drejtesia.gov.al	Shkodër: ndihmajuridike.shkoder@drejtesia.gov.al
Tiranë: ndihma.juridike@drejtesia.gov.al	Gjirokastër: ndihmajuridike.gjirokaster@drejtesia.gov.al
Durrës: ndihmajuridike.durres@drejtesia.gov.al	Pogradec: ndihmajuridike.pogradec@drejtesia.gov.al
Fier: ndihmajuridike.fier@drejtesia.gov.al	Vlorë: ndihmajuridike.pogradec@drejtesia.gov.al
Lushnjë: ndihma.juridikelushnje@drejtesia.gov.al	Dibër: ndihmajuridike.diber@drejtesia.gov.al
Lezhë: ndihmajuridike.lezhe@drejtesia.gov.al	

Ruajtja e provave



Përgjatë nismave tuaja ju mund ta zhvilloni të gjithë aktivizmin në bashkëpunim vetëm me komunitetin dhe jo domosdoshmërisht do të krijoni marrëdhënie me autoritetet publike, por në çdo rast ju duhet të siguroheni se po tregoheni korrekt ndaj fakteve.

Çdo artikulum i juaji, pretendim apo informacion i shpërndarë mund të kundërshtohet nga palë të tjera, të cilat mund të mjaftohen duke ju akuzuar publikisht, vetëm me qëllim delegjitimitimin tuaj ose mund t'ju padisin në gjykatë.

Prova është miku juaj më besnik, që do ju shoqërojë në çdo të papritur që mund të hasni në kauzën tuaj. Është e rëndësishme të njihni disa nga risqet dhe mënyrat se si mund t'i zbusni ato.

Ju duhet t'i ruani "provat" për kauzën tuaj të paktën 5 vite, pasi palët që preken nga nisma juaj në çdo kohë mund të ndërmarrin hapa ligjorë kundër jush ose të nisin fushata shpifjesh, denigrimi apo kërcënimi, të cilat kanë gjetur një mjedis të favorshëm në epokën e internetit dhe të mediave sociale.

Një përfitim tjetër nga ruajtja e provave është përdorimi i tyre në përballjen me funksionarët publikë, të cilët mund t'ju ftojnë në takime të

hapura, komisione apo këshilla që kanë marrë në shqyrtim çështjen e ngritur nga ju.

Në një periudhë ku artikulumet boshe kanë zënë hapësira të shumta në komunikimin virtual, ju mund të tërhiqni vëmendjen përmes përdorimit të fakteve, që mund të mos njihen gjerësisht nga publiku dhe kjo rrit besueshmërinë tek kauza juaj.

Gjithashtu media është me e interesuar për probleme të cilat shoqërohen me fakte ilustruese, ku shpjegohen detajet, paraqitet dokumentacioni i mbledhur dhe identifikohen përgjegjësit. Kjo qasje do të tërheqi vëmendjen e gazetarëve dhe interesin e tyre për të zhvilluar me ju intervista.

Çdo provë e mbledhur nga ju mund të përodret edhe nga aktivistë të tjerë apo Organizata të Shoqërisë Civile, të cilët në të ardhmen mund të vijnë në ndjekin kauzën tuaj. Gjithashtu agjencitë ligjzbatuese, si policia, prokuroria dhe autoritete të tjera mund të zhvillojnë hetime dhe të nxjerrin konkluzione përmes ndihmës që ju mund të ofroni, duke i paraqitur provat që keni mbledhur.

Ju mund të bëheni iniciues i këtyre hetimeve ose në raste të tjera ju mund të thirrreni për të depozituar provat tuaja



Cilat janë përfitimet ruajtjes së provave?

- 01 I dërgoni tek autoritetet ligjzbatuese me karakter penal ose administrativ;
- 02 Mund t'i dejtoheni gjykatës për të paditur përgjegjësit;
- 03 I përdorni për tu mbrojtur nëse hapet një proces ligjor kundër jush;
- 04 Ndhmoni nisma të ngjashme në të ardhmen;
- 05 Mund të ndiqni vijimin e problemit përmes procesit "follow up" dhe "fact-checking";
- 06 Ndhmoni gazetarët që të thellohen më tej në raportimet e tyre për çështjet që lidhen me kauzën tuaj;
- 07 Përballeni me sulmet apo fushatat e dezinformimit ose të shpifjeve që mund të adresohen ndaj jush.

Komunikimi formal

Kur i drejtoheni autoriteteve publike përdorni dy froma, përmes postës direkte ose përmes asaj elektronike, "e-mail". Në çdo rast edhe nëse kontaktoheni përmes telefonit, ju lihet takim apo ju dërgohet mesazh në celularin tuaj, kërkonte që komunikimi të vijojë përmes formës zyrtare, që është përgjigja me shkresë ose "e-mail".

Formati zyrtar

Kur i drejtoheni autoriteteve publike përdorni dy froma, përmes postës direkte ose përmes asaj elektronike, "e-mail". Në çdo rast edhe nëse kontaktoheni përmes telefonit, ju lihet takim apo ju dërgohet mesazh në celularin tuaj, kërkonte që komunikimi të vijojë përmes formës zyrtare, që është përgjigja me shkresë ose "e-mail".

Ruajini përgjigjet

Çdo përgjigje që vjen nga autoriteti publik në formë fizike apo përmes "e-mailit" duhet ruajtur dhe shumëfishuar. Përgjigjet me "e-mail" janë lehtësisht të gjetshme edhe në një moment të dytë, ndërsa më shumë kujdes duhet treguar për kopjet fizike. Megjithatë rrisi i humbjes apo i dëmtimit ekziston gjithmonë, prandaj në çdo rast ato duhen shumëfishuar dhe të depozitohen në vende të sigurta. Gjithashtu çdo formë tjetër komunikimi përmes së cilës ju qasen zyrtarët, palët e interesuara apo autoritetet publike, duhen dokumentuar dhe ruajtur.

Mbani shënim

Kur i dërgoni shkresa autoriteteve publike, shënoni datën e nisjes përmes postës direkte dhe ruani mandatin e depozitimit. Nëse e depozitoni vetë pranë regjistrimit të protokollit të institucionit kërkonte të merrni numrin e regjistrimit. Gjithashtu mbani shënim datën kur dërgoni një "e-mail", nëse ai ju fshihet gabimisht në postën tuaj elektronike, mund të gjendet më lehtësisht tek ajo e autoritetit publik.



Kërkimi në internet

Shkarkojini materialet

Dokumentet e çdo formati, fotografitë, videot, linqet dhe elementë të ngjashëm që shfaqen në faqet e internetit mund të ndryshohen apo të fshihen në çdo kohë. Nëse ju riktheheni në të njëjtën faqe mund të mos e gjeni më informacionin apo dokumentin që kishit vizituar më herët, prandaj shkarkoni çdo material me interes për ju.

Kontrolloni vërtetësinë

Kur vizitoni faqet e autoriteteve publike kontrolloni vërtetësinë e tyre. Shihni strukturën e faqes, "domainin" - institucionet pas adresave të tyre përdorin emërtimin "[.gov.al](#)". Gjithashtu përpara adresës në internet sigurohuni që të fillojë me: [https](#) - e cila garanton që komunikimi juaj është privat dhe i koduar. Gjithashtu në komunikimet zyrtare përdorni emailt që kanë "domainet" e institucioneve, për shembull: erion.veliaj@tirana.al.

Dokumentoni

Faqet në internet funksionojnë përmes kodimit dhe në çdo rast struktura e tyre mund të ndryshojë, së bashku me përmbajtjen në to. Data, ora, teksti dhe çdo element i ngjashëm është lehtësisht i manipulueshëm dhe i shkatërrueshëm. Kur dëshironi të ruani një pamje përdorni programet apo opsionet "*print screen*", në kompjuter dhe "*screenshot*", në telefonin "*mobile*". Gjithashtu mund të përdorni programet ose opsionet "*screen record*", përmes të cilit regjistroni me video pamjen e ekranit. Gjithashtu ju mund të konvertoni linkun e faqes në "*pdf*" ("*Convert web page to PDF*") dhe e ruani të plotë si dokument.

Ruajini linqet

Motorët e kërkimit përpunojnë çdo ditë informacione të reja për institucionet, zyrtarët dhe ato pasurohen përmes teksteve, fotove, videove dhe skedarëve të tjerë, të cilat shtojnë materialet që rezultojnë për to në internet. Nëse kërkoni përsëri me të njëjtat fjalë kyçe apo fjali, jo gjithmonë është e lehtë ta gjeni sërish të njëjtën faqe. Forma më e mirë është që t'i ruani linqet në një dokument të veçantë.



Gazetaria qytetare

Krijimi i përmbajtjes

Teknologjia e celularëve "smartphone" dhe interneti i ka kthyer qytetarët sot edhe në prodhues individual, duke pasur blogjet e tyre në internet apo faqet në mediat sociale. Qytetarët prodhojnë dhe shpërndajnë lajme, duke tejkaluar median tradicionale dhe duke dalë si burime informacioni në skenën mbarëbotërore që ofron interneti.

Regjistroni

Dokumentimi përmes fotografive dhe videove ju ndihmon që të krijoni prova për kauzën tuaj. Ju mund ta nisni që nga dokumentimi i situatës në terren, duke u kujdesur të filmoni elementë që tregojnë gjendjen në përgjithësi dhe detajet. Nëse ju ftoheni në diskutime publike, merrni pjesë apo përballeni me premtime të zyrtarëve publikë, filmojini ato me zë dhe me figurë sepse është një provë që ju ndihmon si aktivistë që të kërkonin llogari në të ardhmen. Për të krijuar përmbajtje multimediale ju duhet të përdorni dy ose më shumë formate, si tekste, video, audio dhe foto të integruara me njëra-tjetrën dhe t'i shpërndani ato në rrjetet sociale, duke rritur kështu vizibilitetin për kauzën tuaj. Ju gjithashtu mund të blini pajisje shtesë që ju ndihmojnë për një vizualizim më profesional.



Burimi:

<http://mediatype.be/2018/01/30/kit-advice-shooting-editing-with-smartphone-mojo/>

Webliografia:

- <https://app.gov.al>
- <https://qkb.gov.al>
- <https://konsultimipublik.gov.al>
- <https://konsultimivendor.al>
- <https://www.instat.gov.al>
- <http://gjykata.gov.al>
- <http://vendime.al>
- <https://www.openprocurement.al>
- <http://vullnetarizmi.al>
- <http://financatvendore.al>
- <http://km.levizalbania.al>
- <http://portavendore.al>
- <https://juristionline.al>
- <http://www.pyetshtetin.al>
- <https://ahc.org.al>
- <https://www.co-plan.org>

Bibliografia:

- S. Brooks, Brian, Kennedy, George, R. Moen, Darly, Ranly, Don, "Raportimi dhe shkrimi i lajmeve", faqe 13 dhe 277, Botimet IDK, Tiranë;
- Ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji nr. 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik";
- Ligji nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit";
- "Mjetet dhe teknikat e raportimit të lajmit lokal", Geri Emiri, 2019, Durrës;
- "Nga ABC-ja e gazetarisë tek hulumtimi ", Geri Emiri, 2019, Durrës;
- "Mini-udhëzues për aktivistët lokal në Shqipëri", Geri Emiri, 2022.

Për më shumë lexoni edhe publikimet e ngjashme të autorit:

- "Mjetet dhe teknikat e raportimit të lajmit lokal"
 - "Nga ABC-ja e gazetarisë tek hulumtimi"
 - "Mini-udhëzues për aktivistët lokal në Shqipëri"
- *Këto publikime i gjeni në platformën www.academia.edu - në profilin: Geri Emiri*

RRETH AUTORIT

Ka mbaruar studimet për “Gazetari dhe Komunikim” në Universitetin e Tiranës dhe ka studiuar për “Marrëdhëniet me Publikun”, në nivelin “Master Shkencor” (MSc.), në Universitetin e Tiranës. Ka punuar në disa media online dhe në televizion, si edhe ka realizuar emisione historike dhe dokumentarë për çështjet mjedisore. Është themelues dhe kryeredaktor i medias në internet “Amfora.al”, e profilizuar në raportimin mbi arkeologjinë, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin në Shqipëri. Është vlerësuar me disa çmime si gazetar, ndër to, Çmimi i Bashkimit Evropian për Gazetarinë Investigative në Shqipëri për vitin 2020, vendi i dytë.

Prej vitesh është i angazhuar si aktivist dhe vullnetar në organizatat e shoqërisë civile. Ai është bashkëthemelues i grupimit “Bicycle Durrës”, që advokon për infrastrukturën dedikuar biçikletave në Durrës.

“*Demokracia po përballet çdo ditë me sfida të reja që tentojnë të zbehin forcën e saj dhe bashkëpunimi i ngushtë midis aktivistëve dhe gazetarëve besoj se ndihmon në ruajtjen e këtyre vlerave të shenjta për zhvillimin e shoqërisë në mënyrë të shëndetshme. Gjithashtu ndryshimet në komunitetet lokale arrihen më lehtë përmes bashkëpunimit të aktivistëve dhe gazetarëve, prandaj duhet kultivuar një marrëdhënie e vazhdueshme midis këtyre dy aktorëve*”

Për çdo bashkëpunim, sugjerim apo pyetje, lutem të më kontaktoni në adresat:

Email: emirigeri@gmail.com

Twitter: @Geri_Emiri

Geri Emiri

Kryeredaktor, Media Amfora.al





☆☆☆ **#shkëndija**

SI TË FAKTOJMË?!

Mini-udhëzues për
aktivistët lokal në
Shqipëri